

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025

(java e 51, deri më 21.12.2025)


TË DHËNA JAVORE

Gjatë javës së 51 të vitit 2025 (nga 15-21.12.2025), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **314 (I=7,6/100.000)** raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 2,3 herë më shumë se javën që shkoi (134).

Në javën e 51 të vitit të kaluar janë regjistruar 139 të sëmurë (ritje për 2,3 herë), ndërsa krahasuar me modelin për 15 sezonet e fundit (362) është regjistruar një rënie prej 13,3%.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit (I=22,03/100.000) është nën pragun sezonal, gjegjësisht ende nuk është arritur pragu i hyrjes në sezonin e gripit.

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike 2010-2025, sezoni 2024/2025 dhe sezoni 2025/2026




Sa i përket grupmoshës, tek grupmosha nga 15-64 vjet janë regjistruar 190 të sëmurë, ndërsa tek grupmosha mbi 65 vjet – 17, tek grupmosha 5-14 vjet - 65 dhe tek grupmosha 0-4 vjet – 42 të sëmurë.

Personat e sëmurë të kësaj jave janë regjistruar në 21 QSHP/NJR, pra në Tetovë – 65, Shkup – 63, Kumanovë – 39, Veles - 30, Dibër – 23, Strumicë – 18, Makedonski Brod – 11, ndërsa në Prilep, Kavadar, Gostivar, Prespë, Shtip, Ohër, Strugë, Vinicë, Demir Hisar, Radovich, Manastir, Negotinë, Sveti Nikole dhe Krushevë numri i të sëmurëve është nën 10.

Në 11 njësi raportimi të cilat kanë raportuar për raste të gripit në 8 – është regjistruar aktivitet sezonal i virusit të gripit, ndërsa në 2 aktivitet mesatar.

Hartogrami 1. *Niveli i aktivitetit të gripit dhe incidenca në 100.000 banorë, java 51, 2025*



Mbikëqyrja virologjike

Gjatë javës së 51 të raportimit pranë pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 28 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuara për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV. Nga materialet e testuara 5 kanë rezultuar pozitiv për prani të virusit të gripit - 2 Influenza A(H3) dhe 2 Influenza A(H1)pdm, si dhe 1 Influenza A e pasubtipizuar.

Nuk është regjistruar rast pozitiv me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar edhe 2 raste pozitive me RSV.

TË DHËNA KUMULATIVE

Mbikëqyrja epidemiologjike

Gjatë sezonit 2025/2026 numri i përgjithshëm i të prekurve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin është **1.329 (I=72,4/100.000)**.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=799) numri i rasteve të raportuara është rritur për 66,3%, ndërsa krahasuar me modelin për 15 vitet e fundit (n=1342) është regjistruar një rritje prej 0,9%.

Të sëmurë janë regjistruar në gjithsej 23 QShP/NjR. Numri më i madh i të sëmurëve (n=283) është regjistruar në Kumanovë, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (I=692,3/100.000) në Makedonski Brod.

Sa i përket shpërndarjes të të sëmurëve sipas grupmoshës, numri më i madh i të sëmurëve bëjnë pjesë në grupmoshën që përfshin numrin më të madh të popullatës (nga 15-64 vjet) – 956 raste (79,0%).

Shpërndarja e rasteve sipas muajve:

- tetor – 338 raste ose 25,4%
- nëntor – 438 raste ose 33,0%
- dhjetor (deri më 21.12.2025) – 553 raste ose 41,6%

Deri më tani nuk janë regjistruar raste të vdekjes si pasojë e gripit.

Mbikëqyrja virologjike

Deri më tani në sezonin 2025/26, pranë laboratorit të virologjisë në Institutin e Shëndetit Publik të RMV-së kanë arritur 293 materiale nga mbikëqyrja rutinore dhe SARI për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuara për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Nga numri i përgjithshëm i materialeve të analizuara janë zbuluar 12 raste pozitive të gripit – 5 Influenza A(H1)pdm09, 6 A(H3). Janë regjistruar 5 rezultate pozitive për SARS-CoV-2 dhe 8 pozitive për RSV.

KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një variacion i numrit dhe incidencës të sëmundjeve të ngjashme me gripin në bazë javore, por kjo mbetet në nivel messezonal. Edhe pse janë regjistruar rastet e para të gripit, përqindja e rasteve pozitive mbetet nën 10%. Sipas këtyre të dhënave aktiviteti i virusit të gripit ende është sporadik dhe me intensitet të ulët të qarkullimit.

MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

*Burimi: <https://sezonskigrip.mk/>

Masat e përgjithshme për mbrojtje nga gripi kanë për qëllim parandalimin e të gjitha sëmundjeve akute të frymëmarrjes dhe mund të jenë shumë të dobishme, veçanërisht nëse zbatohen gjatë gjithë periudhës së dimrit:

- Evitoni grumbullimin dhe qëndrimin në dhoma ku qëndrojnë më shumë njerëz, sidomos kontaktin e ngushtë me njerëz që janë të sëmurë ose që kolliten, teshtijnë, kanë temperaturë të lartë të trupit.
- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose me dezinfektues.
- Ngrohni dhomat në të cilat qëndroni dhe ajrosini ato shpesh.
- Këshillohet të vishni rroba të ngrohta, në disa shtresa, të bëni banjo të ngrohta.
- Pini pije të nxehta (çajra dhe supa), lëngje frutash, ujë me limon.
- Hani produkte të freskëta të pasura me vitamina dhe minerale, më së miri fruta dhe perime që janë më të mira e të nevojshme për trupin. Produktet e pasura me vitaminë C (limona, portokalle) janë veçanërisht të dobishme. Nëse produktet ushqimore të freskëta nuk janë gjithmonë të disponueshme, mund të përdoren edhe pije dhe preparate multivitaminike.
- Praktikoni një stil jetese dhe zakone të shëndetshme, duke përfshirë këtu gjumin dhe pushimin e mirë, të ushqyerit e shëndetshëm, ruajtjen e aktivitetit fizik dhe mendor dhe uljen e stresit.

Sistemi i fortë imunologjik do t'ju ndihmojë të qëndroni të shëndetshëm ose ta përballoni më lehtë gripin dhe sëmundjet e ngjashme me gripin. Megjithatë, edhe nëse jeni plotësisht të shëndetshëm dhe keni një sistem imunologjik të fortë, prapëseprapë mund të sëmureni me grip ose një sëmundje të ngjashme me gripin.

Çfarë duhet të bëni nëse sëmureni nga gripi?

Ndiqni këto rekomandime:

- Qëndroni në shtëpi dhe mos shkoni në punë, shkollë ose në vende ku ka shumë njerëz.
- Pushoni dhe konsumoni shumë lëngje dhe ushqime të lehta.
- Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit me të cilët jetoni, mos pranoni vizitorë ndërsa jeni të sëmurë.
- Mbuloni hundën dhe gojën me një pecetë kur kolliteni dhe teshtini. Pas përdorimit, hidhni ato në plehra.
- Mbani maskë mbrojtëse kur kontaktoni me të afërmit tuaj në shtëpi, kur kolliteni dhe teshtini.
- Praktikoni larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- Përdorni peceta të lagta që përmbajnë alkool ose dezinfektues për pastrimin e duarve.
- Shmangni preken e syve, hundës dhe gojës me duar.
- Ajrosni shpesh dhomën ku qëndroni gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbajeni mjedisin tuaj të pastër - objekte, sipërfaqe, me produkte higjienike shtëpiake.
- Nëse jeni mbi 65 vjet ose keni sëmundje kronike, ose nëse simptomat e sëmundjes përkeqësohen ose zgjasin për disa ditë - kërkonin ndihmë mjekësore.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

❖ Për sezonin 2025/2026, Ministria e shëndetësisë siguroi 80.000 doza të vaksinë katërvalente falas për grupet prioritete të popullatës.

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 16.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vakcinacija.mk.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike, nga fillimi i vaksinimit e deri në përmbylljen e këtij raporti **gjithsej janë vaksinuar 77.072 persona të kategorive të cënueshme të popullatës me vakcina falas.**

❖ 2.400 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike **me vakcina komerciale janë vaksinuar gjithsej 1.805 persona.**

Në Maqedoninë e Veriut janë vaksinuar gjithsej 78.877 persona me vakcina falas dhe vakcina komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Sipas Raportit të ERVISS të publikuar në javën e 50 të vitit 2025:

Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute (ARI) është rritur mbi nivelet bazë në 24 nga 32 vendet rajonit evropian të OBSH-së që raportojnë.

Gripi është përgjithësisht i përhapur në të gjithë Rajonin Evropian, me disa vende dhe zona që raportojnë intensitet, zbulime dhe shkallë pozitiviteti në rritje. Shkalla e pozitivitetit të gripit në mbikëqyrjen sentinel është më e larta tek fëmijët e moshës 5 deri në 14 vjeç. Një përqindje më e lartë e hospitalizimeve janë tek njerëzit e moshës 65 vjeç e lart. Gripi i tipit A (H3) mbetet virusi mbizotërues në qarkullim.

Indikatorët rajonalë të aktivitetit të SARS-CoV-2 vazhdojnë të bien.

Detektimet e RSV dhe normat e pozitivitetit vazhdojnë të rriten gradualisht në nivel rajonal, me normat më të larta të regjistruara tek fëmijët nën 5 vjeç.

***Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik***